



**QZHDI- Qendra Shqiptare per
Demokratizimin e Institucioneve**

F T E S E

Znj./Z.. _____

Qendra Shqiptare per Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) dhe Fondacioni publik Gjerman “Friedrich Ebert” (FES) organizojne më 16.03.2006 ora 10.00 në Shkodër (Hotel-Restaurant “Colosseo”), Forumin e pare diskusional me teme:

“Mediat dhe Procesi i Decentralizimit nen Optiken e Integritit European ”

Shqiperia eshte futur perfundimisht ne rrugen e Integritit European dhe, sipas te gjitha gjasave, pranvera e ketij viti do te shenoje nje hap tjeter te rendesishem ne kete drejtim: nenshkrimin e Marreveshjes se Stabilizim-Asociimit nga vendet anetare te Bashkimit European.

Por, rruga e gjate e Shqiperise drejt ketij procesi te nderlikuar mund te shkaktoje keqkuptime ne opinionin publik Shqiptar, ne rast se percillet ne menyre te percipite nga mediat e Vendit, te cilat nuk kane ende informacionin e duhur, ose nuk e njohin ne brendesi kete proces madhor.

Me ane te ketij projekti, organizatoret synojne te trajtojne problematiken e Integritit nen aspektin specifik te Decentralizimit te Pushtetit Vendor, nepermjet nxitjes dhe aktivizimit te metejshem te mediave lokale.

Ne *Forumin e pare* do te referoje z. Fatlum Nurja, ekspert i LGDA- se, mbi pasqyrimin e procesit te Decentralizimit te pushtetit Vendor ne mediat qendrore dhe lokale, cka do te perbeje edhe objektin e diskutimit te metejshem nga te pranishmit. Te ftuar ne kete takim jane: gazetare te rajonit te Shkodres (duke perfshire mediat lokale te Koplikut dhe Lezhes), perfaqesues te pushtetit Vendor, shoqerise Civile dhe organizatave nderkombetare qe veprojne ne Shkoder. Per te marre pjese ne kete takim, ka shprehur interes per z. Dr. Christian Jetzlsperger, sekretar i Ambasades se RF te Gjermanise ne Tirane.

Do te kishim kenaqesine te na nderonit me pjesemarrjen Tuaj aktive ne debat.

Dr. Aleksander DHIMA
Fondacioni “Friedrich Ebert”
Zyra e Tiranes

Illir ALIAJ
Drejtor ekzekutiv i Qendres per Zhvillimin dhe
Demokratizimin e Institucioneve